




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br Prot. <u>01-3366/13</u>
Nr. i faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>14.10.2013</u>
Nr. pages	Date
	<u>14.10.2013</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.10.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-2780/13, për z. Fatmir Dragidella – Drejtor i Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës, dhe Prodekan i Fakultetit të Mjekësisë, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur për Zyrtarin e lartë, z.Fatmir Dragidella – Prodekan ne Fakultetin e Mjekësisë dhe Drejtor i Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës, nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2780/13, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-2780/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z.Dragidella së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar se ushtrimi i këtyre dy funksioneve njëkohësisht sipas Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike paraqet konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tij publik (Neni 7 paragrafi 8, si dhe Neni 16 paragrafi 1).

Zyrtari i lartë. z.Dragidella është deklaruar se ka pas dyshime edhe vet për situatën e tillë, por ka qenë i këshilluar që kjo nuk paraqet konflikt interesi. Por, pas interpretimit të ligjit që i është bërë nga zyrtarët e Agjencisë, ztr. Dragidella ka deklaruar se do të jap dorëheqje nga funksioni i Drejtorit të Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK), për të ushtruar vetëm funksionin e tij prej Prodekani të Fakultetit të mjekësisë.

Ndërkohë z.Dragidella, me datë 07.10.2013 në Agjenci ka sjellë shkresën e tij zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë (02-05-6063) e cila përmbante Dorëheqjen që ky zyrtar i lartë i ka ofruar U.D.Sekretarit të Përgjithshëm të M.SH. ztr.Gani Shabani si dhe Ministrit Agani.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

